



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr.1028/4 Prot.

Tiranë, më 19/ 12/ 2017

V E N D I M

Nr.178, Datë 19/12/2017

PËR

AUDITIMITN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PREFEKTIT TË QARKUT VLORË “PËR AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË” PËR PERIU DHEN 01.07.2014 DERI 30.09.2017.

Nga auditimi i ushtruar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Vlorë rezultoi që, të ketë devijime nga kuadri ligjor rregullator në fuqi (kriteret) dhe për përmirësimin e gjendjes i janë rekomanduar Institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë marrja e masave organizative.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë” të ushtruar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Vlorë, për periudhën 01.01.2013 deri më 31.07.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. KONKLUZIONE/OPINJONE:

Nga auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë të kryer në *Institucionin e Prefektit të Qarkut Vlorë*, në referencë të standardeve INTOSAI dhe në përputhje me kërkesat e Manualit të Përputhshmërisë së KLSH-së, rezultuan devijime nga kuadri ligjor rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur të KLSH, justifikojnë dhënien e një **Opinionit të Kualifikuar**. Devijimet kryesore në gjykimin tonë materiale lidhen me:

- *Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë*, organikën dhe strukturën nga 30 punonjës të miratuar është plotësuar me 17 punonjës, nga të cilët 4 punonjës nuk janë nëpunës të shërbimit civil. Për 13 vende të lira pune plotësimi ka vazhduar nëpërmjet DAP, por deri me

datë 30.09.2017, struktura rezulton e paplotësuar. *Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë*, nuk ka bërë evidentimin në kontabilitet të objekteve ndërtimore, Menaxheri i lartë nuk ka siguruar hartimin e gjurmës së auditit për nxjerrjen e përgjegjësive para likuidimit të vendimeve gjyqësore, nuk është hapur regjistri i aktiveve, si dhe nuk është bërë regjistrimi i ndërtesave në ZVRPP Vlorë.

- *Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë*, pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë, për periudhën 01.07.2014 deri me datë 30.09.2017 **nuk ka marrë asnjë vendim me kontrollet e drejtpërdrejta, të ushtruara me nismën e vet**, në ish-NB-të dhe në zonat me përparësi turizmi. *Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë*, nga **13 vendime** me sipërfaqe **51152 m²**, të cilët kanë marrë formë të prerë nga gjykata, **nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj anëtareve të komisioneve të ndarjes së tokës të të gjitha niveleve, pasi kanë tejkaluar kompetencat ligjore, të cilat kanë sjellë, dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit, duke ndarë tokë bujqësore mbi normën për frymë ose duke mos qenë banor.**

- *Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë*, tokën bujqësorë me sipërfaqe **51152 m²**, e kanë dorëzuar në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut Vlorë (DAMT) **mënyrë fiktive**, pasi toka bujqësore **vazhdon të përdoret nga persona fizikë dhe juridik të cilët e kanë përfituar në kundërshtim me ligjin**. *Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë*, për **6 vendime** me sipërfaqe **42530 m²** edhe pse nuk kanë marrë formë të prerë nga gjykatat, nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj anëtareve të komisioneve të ndarjes së tokës të të gjitha niveleve, pasi kanë tejkaluar kompetencat ligjore, të cilat kanë sjellë, dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit, duke ndarë tokë bujqësore mbi normën për frymë ose duke mos qenë banor.

- *Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë*, me vendim nr. 13, datë 22.07.2013, në AMTP pa numër, datë 01.10.1995, nuk ka trajtuar zërin kadastral truall me sipërfaqe **500 m²**. *Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë*, në **10 vendime** të marra me sipërfaqe **79850 m²**, në lidhje me rikonfirmimin e AMTP-ve mungon informacioni nga kryetari i komunës/bashkisë dhe nga DAMT Qarku Vlorë.

- *Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë*, në **34 raste** shqyrtimin e kërkesave të ardhura nga institucione të ndryshme e ka bërë jashtë afateve ligjore dhe në **29 raste** dosjet janë pa inventarizuar, si dhe nuk përmban personin dorëzues dhe marrësin në dorëzim.

Këto devijime nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur të KLSH, nuk janë materiale por devijime të konstatuara në disa raste, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar dhe për përmirësimin e gjendjes i është rekomanduar Institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë, marrja e masave organizative.

B. MASA ORGANIZATIVE

1 - Gjetje nga auditimi: Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë, **nuk ka plotësuar organikën dhe strukturën me numrin e punonjësve**. Organikën dhe strukturën nga 30 punonjës të miratuar e ka plotësuar me 17 punonjës nga të cilët 4 punonjës nuk janë nëpunës të shërbimit civil. Për 13 vende të lira pune plotësimi ka vazhduar nëpërmjet DAP, por deri me datë 30.09.2017, struktura rezulton e paplotësuar, veprim në papajtueshmëri me ligji nr. 8927, datë 25.07.2002 “Për Prefektin”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 7-9, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 - Rekomandim: Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë të marrë masa, të plotësojë strukturën organike me numrin e punonjësve sipas organikës dhe strukturës së miratuar.

Në vijimësi

2 - Gjetje nga auditimi: Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë, për punonjës të cilët janë larguar nga puna **nuk ka likuiduar vendimin e gjykatës** nr. 2403, datë 12.11.2010, në vlerën 621180 lekë dhe vendimin nr. 773, datë 18.05.2016 në vlerën 434,600 lekë, veprim në papajtueshmëri me pikën 3 neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin

financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 14-19, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1- Rekomandimi: Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë të marrë masa, të bëjë likuidimin e vendimeve të gjykatës për punonjësit e larguar nga puna.

Në vijimësi

3 - Gjetje nga auditimi: Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë, për vitin 2012, 2013, 2014, 2015, 2016 ka paguar kamat vonesa ndaj OSHE për fatura të prapambetura në vlerën 84,547 lekë, veprim në papajtueshmëri me germën **gj** pika 3 neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 19-20, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1 - Rekomandimi: Institucioni i Prefektit të Vlorë të marrë masa, të analizoj pagesën e kamatëvonesave për energjinë elektrike, duke përcaktuar shkaqet dhe personat përgjegjës.

Në vijimësi

4 - Gjetje nga auditimi: Në Institucionin e Prefektit të Qarkut Vlorë, llogaria 468 “debitorë të ndryshëm” paraqitet vlerën 659,884 lekë, që përfaqësojnë detyrime të lindura nga vjedhja e një makine në vitin 1997 dhe detyrime të punonjëseve, veprim në papajtueshmëri me pika 3 neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 20-22, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1 - Rekomandim: Institucioni i Prefektit të Vlorë të marrë masa, të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e vlerës **659,884 lekë**.

Në vijimësi

5 - Gjetje nga auditimi: Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë, nuk ka kërkuar nga ZVRPP Vlorë, pajisjen me certifikatë pronësie të objekteve të ndërtimit të cilat i kanë kaluar në pronësi, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 271 datë 21.04.2010 “Për miratimin e listës së Inventarit të pronave të Paluajtshme Shtetërore, i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme, për Nënprefektin Sarandë dhe Administratën e tij” (*Trajtuar hollësisht në faqet 25-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1 - Rekomandim: Prefekti Qarkut Vlorë të marrë masat, të bëjë regjistrimin e objekteve të ndërtimit në ZVRPP Vlorë dhe pajisjen me certifikatë pronësie.

Në vijimësi

6 - Gjetje nga auditimi: Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë, në 9 procedura prokurimi me vlerë 381,000 lekë (me tvsh), nuk janë përmbush rregullat e caktuara, si dhe nuk janë marr në dorëzim aktivet afatgjata dhe afatshkurta, veprim në papajtueshmëri me nenin 1, 2 dhe 24, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe kreu V, pika 1/a dhe pika 4/h, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, me pikën 2/a Kreu VI, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (*Trajtuar hollësisht në faqet 26-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1- Rekomandimi: Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë të marrë masa, të eliminojë praktikën që çojnë në efektivitet të ulët të prokurimeve për mallra e shërbime, si dhe të përcaktoj gjurmën standarde të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla.

Në vijimësi

7 - Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor për Verifikimin e Titujve të Pronësisë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë, procesverbalin e mbledhjeve nuk e ka sekretuar nga Zyra e Protokoll Arkivës të Institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë. Në procesverbal nuk janë regjistruar problemat e trajtuar nga relatori i çështjes, nuk janë regjistruar diskutimet e anëtarëve të komisionit, të cilët janë të detyruar të shprehin mendimet e tyre në lidhje me çështjen që relatohen në komisioni.

Prefekti i Qarkut, **në asnjë rast nuk rezulton të ketë thirrur në mbledhjen e komisionit drejtues të institucioneve shtetërore**, që ushtrojnë veprimtari në juridiksionin e qarkut, **drejtues të qeverisjes vendore**, të cilët kanë lidhje dhe informacion me çështjet konkrete, që shqyrtohen në mbledhjen e komisionit vendor.

Komisioni Vendor, për periudhën 01.07.2014 deri me datë 31.12.2014, **nuk ka zhvilluar asnjë mbledhje dhe nuk ka marrë asnjë vendim** në lidhje me kërkesat e ardhur nga individ dhe institucione shtetërore, apo me kontrollet e ushtruara drejtpërsëdrejti, me nismën e vet. Komisioni Vendor sipas procesverbalit të mbledhjes date 22.05.2015, **nuk ka zbardhur vendimin për shfuqizim të pjesshëm të AMTP-së nr. 21231, pa datë** me sipërfaqe **3900 m² në pronësi shtet**, dhe sipas procesverbalit të mbledhjes datë 14.09.2017, **nuk ka zbardhur vendimi për pavlefshmëri të plotë të AMTP-së nr. 155, datë 20.03.2000** me sipërfaqe **9680 m² në pronësi shtet**, veprim në papajtueshmëri me nenin 16 pika 4, të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike“ dhe germën **a, b** pika 6, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 32-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1 - Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë të marrë masa, që procesverbalin e mbledhjeve ta sekretoj nga Zyra e Protokoll Arkivës të Institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë, si dhe të regjistroj diskutimet e anëtarëve të komisionit, të cilët janë të detyruar të shprehin mendimet e tyre në lidhje me çështjen që relatohen në komisioni.

7.2 - Rekomandim: Prefekti i Qarkut, **të thërras në mbledhjen e komisionit drejtues të institucioneve shtetërore dhe të qeverisjes vendore**, të cilët kanë lidhje dhe informacion me çështjet konkrete që shqyrtohen në mbledhjen e Komisionit Vendor.

Komisioni Vendor, të **zhvilloj mbledhje** çdo muaj dhe të marrë vendime në lidhje me kërkesat e ardhur nga individ dhe institucione shtetërore, si dhe të fillojë kontrollet e ushtruara drejtpërsëdrejti, me nismën e vet.

7.3 - Rekomandim: Komisioni Vendor të zbardh vendimin për shfuqizim të pjesshëm të AMTP-së nr. 21231, pa datë me sipërfaqe **3900 m² në pronësi shtet**, dhe të zbardh vendimin për pavlefshmëri të plotë të AMTP-së nr. 155, datë 20.03.2000 me sipërfaqe **9680 m² në pronësi shtet**.

Menjëherë

8 - Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë për **13 vendime** me sipërfaqe **51152 m²**, të cilët kanë marrë formë të prerë nga gjykata, si dhe për **6 vendime** me sipërfaqe **42530 m²**, të cilët nuk kanë marrë forme të prerë nga gjykata, **nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë**, ndaj anëtarëve të komisioneve të ndarjes së tokës të fshatrave, **pasi kanë tejkalluar kompetencat ligjore, të cilët kanë sjellë, për pasojë, me efekt dhe dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit**, duke ndarë tokë bujqësore mbi normën për frymë apo duke mos qenë punonjës të ish-NB-së me datë 01.10.1992, veprim në papajtueshmëri me nenin 15, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 34-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1 - Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë të marrë masa, të bëjë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj anëtarëve të komisionit të ndarjes së tokës në fshat, të cilët pasi kanë tejkalluar kompetencat ligjore, kanë sjelle, dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit, duke ndarë tokë bujqësore mbi normën për frymë.

Menjëherë dhe në vijimësi

9 - Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë për **6 raste**, që i përket periudhës 2013, **për dosjet e shqyrtuara nuk ka hartuar Informacionin përmbledhës dhe Projektvendim**, në lidhje me vlefshmërinë ligjore të AMTP-ve, veprim në papajtueshmëri me germën **a** pika 6 kapitulli III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 34-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1 - Rekomandim: Vendimmarrja e Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë të marrë masa, të hartoj Informacion përmbledhës dhe Projektvendimin përkatës për çështjet dhe vendimet e marra.

Në vijimësi

10 - Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë në **13 vendime** me sipërfaqe **51152 m²**, nuk ka marrë në dorëzim tokën bujqësore të liruar që përdoret në mënyrë të paligjshme nga persona fizikë dhe juridik të cilët e kanë përfituar në kundërshtim me ligjin, nuk ka hartuar marrëveshje ku të përcaktonte se tokën nuk e përdorë, por e ka lënë të lirë, si dhe **nuk ka nxjerrë urdhër ekzekutimi për tokën e lirë në pronësi shtet**. Komisioni Vendor tokën bujqësore e ka dorëzuar në DAMT në Qarkun Vlorë (DAMT), në mënyrë fiktive, pasi toka e përfituar në mënyrë të paligjshme vazhdon të përdoret nga personat fizikë dhe juridik, veprim në papajtueshmëri me pikën 2 nenin 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar dhe pikën 4, Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 34-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1 - Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë të marrë të dorëzoj tokën e liruar që përdoret në mënyrë të paligjshme nga persona fizikë dhe juridik të cilët e kanë përfituar në kundërshtim me ligjin, si dhe të hartoj marrëveshje dhe të **nxjerrë urdhër ekzekutimi për tokën e lirë në pronësi shtet**.

10.2 - Rekomandim: Të eliminohen në të ardhmen praktikat të mos marrjes në dorëzim të tokës bujqësore nga persona fizikë dhe juridik të cilët e kanë përfituar në kundërshtim me ligjin.

Menjëherë

11 - Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Vlorë në **29 raste, shqyrtimin e kërkesave** të ardhura nga subjektet private dhe institucionet shtetërore e ka bërë **jashtë afatit ligjor**, veprim në papajtueshmëri me nenin 9, pika 2, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 34-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1 - Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Vlorë, të marrë masa, që shqyrtimin e kërkesave të ardhura nga subjektet private dhe institucionet shtetërore ti bëjë brenda afatit ligjor.

Menjëherë

12 - Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë nuk ka filluar **kontrollin e drejtpërdrejtë, të ushtruar me nismën e vet, edhe për 23 familjet që kanë përfituar tokë bujqësore në fshatin Risili, duke mos qenë punonjës në ish-NB me datë 01.10.1992, sipas listës të dërguar nga ish-Komuna Shushicë**, me shkresë nr. 75, datë 19.03.2010, dërguar në Komisionin Vendor pranë Prefektit të Qarkut Vlorë, veprim në papajtueshmëri me pikën 3, neni 8, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 34-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1 - Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë të marrë masa, të filloj kontrollin e drejtpërdrejtë, të ushtruar me nismën e vet, për 23 familjet që kanë përfituar tokë bujqësore në fshatin Risili, duke mos qenë punonjës në ish-NB me datë 01.10.1992, dërguar nga ish-Komuna.

Menjëherë

13 - Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, në lidhje me vendimet nr. 16, datë 05.03.2013, rezulton se procesverballi i hartuar me datë 10.11.2014,

për dorëzimin e tokës bujqësore me sipërfaqe 2700 m², në pronësi shtet nuk është nënshkruar nga DAMT;

Në vendimin nr. 1, datë 16.05.2013, për sipërfaqen 9278 m² që kalon në pronësi shtet nuk ndodhet planvendosja e hartuar nga KV;

Në vendimin nr. 2, datë 16.05.2013, në dosje nuk ndodhet procesverbali i dorëzimit në DAMT Qarku Vlorë, i tokës bujqësore me sipërfaqe 8560 m² në pronësi shtet;

Në vendimin nr. 7, datë 16.05.2013, në dosje nuk ndodhet procesverbali i dorëzimit në DAMT Qarku Vlorë tokën bujqësore me sipërfaqe 7400 m² në pronësi shtet;

Në vendimin nr. 14, datë 06.09.05.2013, në dosje nuk ndodhet procesverbali i dorëzimit në DAMT Qarku Vlorë tokën bujqësore me sipërfaqe 3929 m² në pronësi shtet;

Në vendimin nr. 5, datë 22.05.2015, procesverbali në dosje është pa datë dhe pa nënshkrimin e DAMT Qarku Vlorë, për tokën bujqësore me sipërfaqe 2475 m² në pronësi shtet;

Në vendimin nr. 16, datë 22.05.2015, procesverbali në dosje është pa datë dhe pa nënshkrimin e DAMT Qarku Vlorë, për tokën bujqësore me sipërfaqe 450 m² në pronësi shtet;

Në vendimin nr. 23, datë 10.02.2016, procesverbali në dosje është pa datë dhe pa nënshkrimin e DAMT Qarku Vlorë, për tokën bujqësore me sipërfaqe 1400 m² në pronësi shtet, veprim në papajtueshmëri me pikën 2 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar dhe pikën 4, Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar, *(Trajtuar hollësisht në faqet 34-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

13.1 - Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë të marrë masa, sipas vendimet nr. 16, datë 05.03.2013, të dorëzoj me procesverbal në DAMT Qarku Vlorë, tokën bujqësore me sipërfaqe 2700 m², në pronësi shtet;

Sipas vendimit nr. 1, datë 16.05.2013, të hartojë planvendosjen për sipërfaqen 9278 m² që kalon në pronësi shtet;

Sipas vendimit nr. 2, datë 16.05.2013, të dorëzoj me procesverbal në DAMT Qarku Vlorë, tokën bujqësore me sipërfaqe 8560 m² në pronësi shtet;

Sipas vendimit nr. 7, datë 16.05.2013, të dorëzoj me procesverbal në DAMT Qarku Vlorë, tokën bujqësore me sipërfaqe 7400 m² në pronësi shtet;

Sipas vendimit nr. 14, datë 06.09.05.2013, të dorëzoj me procesverbal në DAMT Qarku Vlorë, tokën bujqësore me sipërfaqe 3929 m² në pronësi shtet;

Sipas vendimit nr. 5, datë 22.05.2015, të dorëzoj me procesverbal në DAMT Qarku Vlorë, tokën bujqësore me sipërfaqe 2475 m² në pronësi shtet;

Sipas vendimit nr. 16, datë 22.05.2015, të dorëzoj me procesverbal në DAMT Qarku Vlorë, tokën bujqësore me sipërfaqe 450 m² në pronësi shtet;

Sipas vendimit nr. 23, datë 10.02.2016, të dorëzoj me procesverbal në DAMT Qarku Vlorë, tokën bujqësore me sipërfaqe 1400 m² në pronësi shtet.

Menjëherë

14 - Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë në **10 raste, nuk ka kërkuar nga kryetari i komunës/baskisë, sipërfaqen e tokës bujqësore, të vënë në dispozicion për t'u ndarë**, sipas fshatrave, për ish-kooperativat bujqësore më 01.08.1991 dhe për ish-NB me datë 01.10.1992, numrin e frymëve sipas fshatrave, konfirmimin nëse është lëshuar apo jo akti i marrjes së tokës në pronësi, në sipërfaqen e tokës bujqësore, sipas aktit që verifikohet apo shqyrtohet, për persona të tjerë dhe **nga DAMT në Këshillin e Qarkut**, sipërfaqja e tokës bujqësore, për fshatin ku ndodhet sipërfaqja e përcaktuar në aktin e marrjes së tokës bujqësore në pronësi, të paraqitur për verifikim apo shqyrtim, vënë në dispozicion për t'u ndarë për ish-kooperativat bujqësore më 01.08.1991, dhe për ish-NB me datë 01.10.1992, veprim në papajtueshmëri me nenin 2, 3, 4, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën

bujqësore”, të ndryshuar, pikën 2, shkronja **a**, nënpika **i** dhe **ii** dhe shkronja **b**, nënpika **ii** të UKM nr. 2, datë 13.1.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, kur këtë e kërkojnë individë a institucione” (*Trajtuar hollësisht në faqet 62-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1 - Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë të marrë masa, të kërkojë konfirmim nga kryetari i komunës/bashkisë përkatëse dhe DAMT në Këshillin e Qarkut Vlorë, në lidhje me sipërfaqja e tokës bujqësore, të vënë në dispozicion për t'u ndarë, sipas fshatrave më 01.08.1991, për ish-kooperativat bujqësore apo më 01.10.1992, për ish-ndërmarrjet bujqësore, numri i frymëve, sipas fshatrave, më 01.08.1991, për ish-kooperativat bujqësore, apo më 01.10.1992, për ish-ndërmarrjet bujqësore, konfirmimi nëse është lëshuar apo jo akti i marrjes së tokës në pronësi, në sipërfaqen e tokës bujqësore, sipas aktit që verifikohet apo shqyrtohet, për persona të tjerë dhe nga DAMT në Këshillin e Qarkut, sipërfaqja e tokës bujqësore, për fshatin ku ndodhet sipërfaqja e përcaktuar në aktin e marrjes së tokës bujqësore në pronësi, të paraqitur për verifikim apo shqyrtim, vënë në dispozicion për t'u ndarë më 1.8.1991, për ish-kooperativat bujqësore, apo më 01.10.1992, për ish-ndërmarrjet bujqësore.

Në vijimësi

15 - Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Vlorë, për kontrole të drejtpërdrejta, të ushtruara me nismën e vet, për tokat e ish-NB-ve dhe zonat me përparësi turizmit për periudhën e auditimit **nuk ka marrë asnjë vendim**, veprim në papajtueshmëri me nenin 7, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 54-56, të Projekt Raportit të Auditimit*).

15.1 - Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Vlorë të marrë masa, të zbatoj programin vjetorë për kontrollet e drejtpërdrejta, të ushtruara me nismën e vet, dhe të miratuar nga Komisioni Qeveritar i Tokës Tiranë.

Në vijimësi

16 - Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Vlorë, ka hartuar vendimin **nr. 2, datë 22.05.2015**, dhe ka vendosur “Revokimin” e vendimit nr. 17, datë 05.03.2013 mbi “Pavlefshmërinë e pjeshme të AMTP nr. 20735, pa datë, me sipërfaqe 45000 m², në emër të familjes M. F., KV pranë Prefektit të Qarkut Vlorë nuk ka iniciuar një hetim administrativ në themel nuk ka analizuar faktin se kjo familje ka **përfitur më shumë tokë se norma për frymë me sipërfaqe 5850 m²**, veprim në papajtueshmëri me pikën 3, neni 8 dhe pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 57-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

16.1 - Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Vlorë, të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin **nr. 2, datë 22.05.2015**, për “Revokimin” e vendimit nr. 17, datë 05.03.2013 mbi “Pavlefshmërinë e pjeshme të AMTP nr. 20735, pa datë, me sipërfaqe 45000 m², në emër të familjes M.F., pasi komisioni i ndarjes së tokës në fshat ka tejkaluar kompetencat ligjore duke ndarë tokë **më shumë se norma për frymë me sipërfaqe 5850 m²**.

Menjëherë

17 - Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Vlorë, ka hartuar vendimin **nr. 3, datë 22.05.2015**, dhe ka vendosur Revokimin e vendimit nr. 12, datë 08.12.2012 mbi “Rikonfirmimin e AMTP nr. 20975, pa datë, me sipërfaqe 3100 m², në emër të familjes I.T., KV pranë Prefektit të Qarkut Vlorë nuk ka iniciuar një hetim administrativ në themel nuk ka analizuar faktin se kjo familje **ka përfitur tokë në ngastrën nr. 203, ZK “Pyll”**, veprim në papajtueshmëri me pikën 3, neni 8 dhe pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore

të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 58-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17.1 - Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefekti të Qarkut Vlorë, të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin **nr. 3, datë 22.05.2015**, për “Revokimin” e vendimit nr. 12, datë 08.12.2012 mbi “Rikonfirmimin e AMTP nr. 20975, pa datë, me sipërfaqe 3100 m², në emër të familjes të I.T., pasi komisioni i ndarjes së tokës në fshat ka tejkualuar kompetencat ligjore duke ndarë tokë në ngastrën nr. 203, **ZK “Pyll” me sipërfaqe 3100 m²**.

Menjëherë

18 - Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefekti të Qarkut Vlorë, ka hartuar vendimin **nr. 7, datë 22.05.2015** dhe ka vendosur Revokimin e vendimit nr. 7, datë 08.10.2012 mbi “Rikonfirmimin e AMTP nr. 20830, pa datë, me sipërfaqe 10000 m², në emër të familjes L. V., KV pranë Prefekti të Qarkut Vlorë nuk ka iniciuar një hetim administrativ në themel nuk ka analizuar faktin se kjo familje **ka përfituar më shumë tokë me sipërfaqe 2750 m²**, veprim në papajtueshmëri me pikën 3, neni 8 dhe pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 59-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.1 - Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefekti të Qarkut Vlorë, të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin **nr. 7, datë 22.05.2015**, për “Revokimin” e vendimit nr. 7, datë 08.10.2012 mbi “Rikonfirmimin e AMTP nr. 20830, pa datë, me sipërfaqe 10000 m², në emër të familjes L.V., pasi komisioni i ndarjes së tokës në fshat ka tejkualuar kompetencat ligjore duke dhënë **më shumë tokë me sipërfaqe 2750 m²**.

Menjëherë

19 - Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefekti të Qarkut Vlorë, **në 2 raste** ka marrë vendimin **nr. 4, datë 22.05.2015** dhe vendimin **nr. 8, datë 22.05.2015**, ka vendosur “Revokimin” e vendimit nr. 13, datë 05.03.2013 mbi “Rikonfirmimin e AMTP nr. 21628, datë 07.09.1998, me sipërfaqe 4500 m², në emër të familjes të R.I. dhe vendimit nr. 3, datë 08.10.2012 mbi “Rikonfirmimin e AMTP nr. 20874, datë 18.06.1996, me sipërfaqe 5000 m², në emër të familjes L. Xh., në të 2 rastet, KV nuk ka iniciuar një hetim administrativ në themel për të analizuar dhe shqyrtuar të gjithë elementët e vlefshmërisë dhe ligjshmërisë së aktit të marrjes së tokës në pronësi, në përfundim ka dal me një vendim abstrakt dhe në tejkalimi të kompetencave ligjore të dhëna nga ligji nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësive të strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar. Vendimi “Revokim”, është në kapërcim të tagrit të KV pasi ligji nuk i njeh të drejtën e Revokimit pa marr një vendimmarrje sa përcaktuar në nenin 9 e në vijim të ligji nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 58-59, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19.1 - Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefekti të Qarkut Vlorë, të marrë masat për rishqyrtim të vendimit **nr. 4, datë 22.05.2015**, për “Revokimin” e vendimit nr. 13, datë 05.03.2013 mbi “Rikonfirmimin e AMTP nr. 21628, datë 07.09.1998, me sipërfaqe 4500 m², në emër të familjes R.I. dhe vendimit **nr. 8, datë 22.05.2015**, për “Revokimin” vendimit nr. 3, datë 08.10.2012 mbi “Rikonfirmimin e AMTP nr. 20874, datë 18.06.1996, me sipërfaqe 5000 m², në emër të familjes L.Xh., duke marr një vendim në përmbushje të detyrës funksionale në zbatim të tagrit ligjor të përcaktuar nga neni 9 e në vijim të ligji nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar.

Menjëherë

20 - Gjetje nga auditimi: Nga 20 masa organizative të lëna nga KLSH, janë zbatuar **14 masa**, në proces zbatimi **1 masë** dhe pa zbatuar **6 masa**. Gjykata Administrative Vlorë, me vendim nr. 638, datë 08.05.2015 ka vendosur shfuqizimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH-lidhur me shpërblimin e dëmit në shumën **1,933,320** lekë dhe masat disiplinore. Mos zbatimi i rekomandimeve nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë, vjen në papajtueshmëri me nenin 15 shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit” (*Trajtuar hollësisht në faqet 7-7, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

20.1 - Rekomandim: Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë të marrë masa, të zbatoj rekomandimet e lënë nga KLSH si dhe të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e gjobave vlerën **1,933,320** lekë.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

C. 1. Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 21, të ligjit nr. 8927, datë 25.07.2002 “Për Prefektin, të ndryshuar dhe ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, ***kërkojmë nga Prefekti i Qarkut Vlorë***, të analizojë punën e Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për **4 punonjës si më poshtë:**

- 1. S. L.**, me detyrë anëtare e Komisionit Vendor;
- 2. P. Ç. (G.)**, me detyrë anëtare e Komisionit Vendor;
- 3. O. Z.**, me detyrë anëtar i Komisionit Vendor;
- 4. E. T.**, me detyrë anëtare e Komisionit Vendor.

- Për moszbatim të kërkesave të nenit 2, 3, 4, 7, 8, 9, 13 dhe 15, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar, VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar.

- Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në marrjen e vendimeve dhe veprimeve të tjera të komisionit vendor për vlerësimin ligjor të titujve të pronësisë, sipas trajtimit në Akt Konstatime dhe në kapitujt përkatës të Raportit Përfundimtar të Auditimit të paraqitur për Institucionin e Prefektit të Qarkut Vlorë.

C. 2. Gjithashtu Prefekti i Qarkut Vlorë të analizojë dhe përgjegjësinë e drejtuesve të Njësisë dhe Nëpunësve të Prefekturës, që përmenden në këtë Raport duke i ballafaquar me urdhëruesit e paraardhësit të tij dhe të marrë masa disiplinore përkatëse.

D. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, (Njësia e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

- 1.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.
- 2.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

Shënim: Për M. Ç., me detyrë ish-Drejtor i Komisionit Vendor larguar nga puna e datë 30.11.2010 dhe G. H., me detyrë ish-Drejtor i Komisionit Vendor larguar nga puna me datë 25.02.2014, do të rekomandonim masë disiplinore “*Vërejte me paralajmërim*”, por për shkak se kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Institucionin e Prefektit të Qarkut Vlorë, masat ndaj tyre konsiderohen të ezazuara.

E. PËR VLERËSIM ORGANIT TË PROKURORISË TË RRETHIT GJYGJËSOR VLORË.

Nisur nga mangësitë dhe shkeljet ligjore të konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtarë të Auditimit në Institucionin e Prefektit të Qarkut Vlorë, mbi veprimtarinë e Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KV), ky Raport do ti përcillet Organit të Prokurorisë për dijeni dhe vlerësim.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë projektvendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R